

“NËSE MARR NJË GJOBË DHE NUK E PAGUAJ, ÇFARË NDODH?”

Ju keni deri në 42 ditë kohë nga marrja e saj, për ta paguar Gjobën të plotë. Nëse pagesa e plotë nuk merret brenda kohës, atëherë autoritetit lokal sipas Ligjit i kërkohet që të fillojë procedurat në Gjykatën e Magjistraturës për shkeljen e parë ligjore të mungesës së paautorizuar të fëmijës tuaj.

Nëse kjo provohet, kjo mund të çojë në gjoba deri në £1,000 dhe/ose një numër urdhrash siç janë Urdhrat e Prindërve ose Dënimet e Komunitetit. Nëse gjendet fajtor, prindi do të marre një shënim kriminal.

“A MUND TË DËNOHEM NËSE E PAGUAJ GJOBËN POR FËMIJA IM AKOMA MUNGON NË SHKOLLË?”

Jo për periudhën e kohës së përfshirë në Gjobë, pagesa jua heq përgjegjësinë në këtë respekt. Megjithatë një ndjekje penale mund të konsiderohet për periudhat e mëtejshme të mungesës së paautorizuar, që nuk mbulohen nga Gjoba, dhe kjo varet nga rrethanat. Nëse kjo është problem, atëherë është e rëndësishme që të punoni shumë afër me shkollën e fëmijës dhe agjensitë e përkrahjes siç është Zyra e Mirëqenies së Arsimit.

“A MUND TË MARR NDIHMË NËSE FËMIJA IM NUK VIJON RREGULLISHT?”

Po, shkolla e fëmijës tuaj dhe Shërbimi i Mirëqenies së Arsimit do ju japin këshilla dhe përkrahje, nëse keni nevojë me vijimin e fëmijës tuaj. Është e rëndësishme që të flisni me shkollën ose me Shërbimin e Mirëqenies së Arsimit, menjëherë, nëse keni shqetësime për sigurimin e vijimit të fëmijës tuaj.

ALBANIAN

Nëse anglishtja nuk është gjuha juaj amtare dhe keni nevojë për një përkthim, ne mund t'ua sigurojmë atë.

BENGALI

ইংরেজী আপনার মাতৃভাষা না হলে এবং আপনার কোন অনুবাদের প্রয়োজন হলে আমরা তা প্রদান করতে সক্ষম।

CHINESE

如果英文不是您的第一语言，而您需要翻译的话，我们可以为您安排。

GUJARATI

જો તમારી પહેલી ભાષા અંગ્રેજી ન હોય અને તમને ભાષાંતરની જરૂર હોય તો અમે તમને તે આવી શરૂઆત કરીએ.

HINDI

यदि अंग्रेजी आपकी पहली भाषा नहीं है और आप को अनुवाद की आवश्यकता है तो यह हम आपकी प्रदान कर सकते हैं।

KURDISH

Heko İngilîzî zîmanê we yê yekem nîno û pêwîstiya we bi wergêr heye, em dikarin yekî ji we re bibînin.

POLISH

Jezeli język angielski nie jest Twoim językiem ojczystym i wymagasz tłumaczenia, możemy to zapewnić.

PORTUGUESE

Se o Inglês não é a sua língua materna e precisa de uma tradução, nós podemos obtê-la.

PUNJABI

ਜੇਕਰ ਇੰਗਲਿਸ਼ ਤੁਹਾਡੀ ਪਹਿਲੀ ਭਾਸ਼ਾ ਨਹੀਂ ਅਤੇ ਤੁਹਾਨੂੰ ਦੁਬਾਰਾ ਵੀ ਤਾਂ ਤੁਹਾਡੇ ਲਈ ਅਸੀਂ ਇਸਦਾ ਪ੍ਰਯੋਗ ਕਰ ਸਕਦੇ ਹਾਂ।

SOMALI

Haddii Ingilisku aanu ahayn alkaaga kowaad oo aad u baahan tahay tuurjumaad, annaga kuu samayn kara.

URDU

اگر انگریزی آپ کی پہلی زبان نہیں ہے اور آپ کو ترجمہ کی ضرورت ہے تو ہم آپ کے لیے فریم کر سکتے ہیں۔

VIETNAMESE

Nếu quý vị không thạo Anh văn và cần bản dịch, chúng tôi sẽ giúp quý vị một bản.

EDUCATION WELFARE SERVICE

North Team
Telefon: 0117 3533686
Fax: 0117 3533688

South Team
Telefon 0117 9031660
Fax: 0117 9031684



Bristol City Council
EDUCATION WELFARE SERVICE

**VIJIMI NË SHKOLLË:
ÇFARË DUHET TË
DINË PRINDËRIT DHE
KUJDESTARËT**

**VIJIMI NË SHKOLLË
ÇDO DITË KA
RËNDËSI
PËRKRAHENI
FËMIJËN TUAJ QË
TË ARRIJNË MË TË
MIRËN E TYRE**

“PSE TË VIJOJ ÇDO DITË?”

Vijimi i mirë në shkollë i jep fëmijës tuaj mundësinë e suksesit dhe e ndimon atë në zhvillimin e përvojave të jetës. Fëmija juaj duhet të vijojë shkollën çdo ditë, vetëm në qoftë se ka arsye të pashmangshme si sëmundja.

Mungesa nga shkolla dëmton mësimin e nxënësit dhe notat e tyre (kërkimet tregojnë se nese mungoni ne shkollë per 17 dite atehere kjo do te ule nje note ne GCSE), ndërpret rutinat dhe i bën nxënësit prehë e lehtë të krimt.

Nxënësit nuk duhet të mungojnë asnjëherë në shkollë për arsye siç janë pazari, ditëlindjet ose të presin një riparues në shtëpi.

Mungesa e shkollës ndikon seriozisht në mundësitë e jetës.

“PSE JEPEN LAJMËRIMET E GJOBËS?”

Prinderit/kujdestarët bëjnë një shkelje ligjore nëse fëmija nuk vijon shkollën rregullisht dhe mungesa nuk është miratuar nga shkolla (e paautorizuar). Në disa raste mungesa e paautorizuar mund të rezultojë në ndjekje penale, kjo sipas Nenit 444, të Ligjit 1999 të Arsimit.

Ligji kundër Sjelljes së Pahijshme të vitit 2003 paraqiti Gjobën, si alternativë për ndjekje penale. Gjoba nuk ka nevojë për paraqitje në gjyq, por ka për qëllim përmirësimin e vijimit në shkollë.

“SA KUSHTON GJOBA?”

£50 nëse pagesa kryhet brenda 28 ditëve. £100 nëse paguhet pas kësaj, por brenda 42 ditëve.

“KUR DO TË PËRDOREN ATO?”

Kur shkolla bie dakord që me pare që fëmija juaj, të mungojë në shkollë ose pranon shpjegimin tuaj për mungesën, në këto raste mungesa është ‘e autorizuar’. Të gjitha mungesat e tjera janë ‘të paautorizuara’.

Lajmërimet e Gjobës mund të përdoren kur mungesa është e paautorizuar, për shembull:

- Një prind e ka marrë fëmijën e tyre me pushime gjatë semestrit pa autorizim, veçanërisht kur do të thotë që fëmijët tuaj humbin provimet, psh. SATs dhe GCSEs.
- Kërkesat në shkollë pas një largimi nga mësimi, tregojnë se mungesa e fëmijës në atë kohë është e pajustificuar.
- Nxënësit janë rregullisht vonë për shkollë pas mbylljes së regjistrimit.
- Një nxënës ka 8 ose më shumë mungesa të paautorizuara brenda 10 javëve të mëparshme.

“ÇFARË DUHET TË BËJ NËSE FËMIJA IM LË MËSIMIN?”

Nëse fëmija juaj lë mësimin ju mund të:

- Bisedoni me ta për të gjetur arsyen pse.
- Takohuni me një pjesëtar të stafit të shkollës për të diskutuar situatën dhe shikoni për zgjidhje.
- Kontaktoni me Shërbimin e Mirëqënies së Arsimit (Education Welfare Service) për këshilla dhe udhëzime. (kontaktoni numrat në faqen tjetër).
- Përpiquni të kuptoni se çfarë po ndodh me fëmijën tuaj dhe i ndihmoni ata në zgjidhjen e problemit.

Arsimi është çelsi i suksesit për të ardhmen e tyre, kështu që është e rëndësishme, që ti zgjidhni problemet sa më shpejt që të jetë e mundur.

“PSE MA KANË DËRGUAR KËTË BROSHURË?”

Kjo broshurë i është dërguar çdo prindi/kujdestari me qëllim që çdo person të vihet në dijeni të nevojës së vijimit të rregullt të fëmijës së tyre dhe në kohë për të arritur më të mirën e tyre.

Është e rëndësishme që prindërit dhe kujdestarët ti kuptojnë përgjegjësitë e tyre dhe pasojat e fëmijës së tyre për mungesë të paautorizuar në shkollë.

“ÇFARË DUHET TË BËJ NËSE FËMIJA IM NUK SHKON NË SHKOLLË?”

Telefononi shkollën sa më herët që të keni mundësi, në mëngjesin e parë të mungesës së tyre dhe jepni arsyen.

I bëni takimet rutinë me doktorin dhe dentistin pas shkollës ose gjatë pushimeve. Nëse duhet të bëni një takim gjatë orarit të shkollës, ndihmoni fëmijën tuaj, që të jetë në shkollë për gjatë gjithë ditës dhe njoftoni shkollën për takimin.

Mundet t’ju kërkohet karta e takimit ose çertifikata shëndetësore, nëse fëmija juaj mungon vazhdimisht për shkak të sëmundjes apo takimeve mjekësore/dentare.

“PO NËSE DUA TË SHKOJ ME PUSHIME?”

Pushimet gjatë kohës së semestrit nuk autorizohen normalisht. Në raste të veçanta, kërkoni leje nga drejtori/drejtoresha dhe kontrolloni rregulloren e shkollës.